



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 464-3623/2025

Klinë, datë 23/10/2025

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, më dt.04.06.2008, nr.28, dispozitat e nenit 85 dhe 154 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nr.05/L-031, nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, më propozimin e Drejtorit të DUMM të datës 21.10.2025, Kryetari i Komunës së Klinës, mori këtë:

V E N D I M

Për pezullim të përkohshëm të vendimit, nr.01-464-3623/2025 të datës 04.02.2025 për miratimin e kërkeses për iniciimin e procedurës së shpronësimit

1. **PEZULLOHET**, ekzekutimi i vendimit nr.01-464-3623/2025 i datës 04.02.2025 që ka të bëjë me miratimin e kërkeses për shqyrtim të mëtejme të iniciimit të procedurës së shpronësimit, me qëllim të realizimit të projektit Zgjerimi dhe Ndërtimi i Rrugës "Malë Bashota" në Klinë.
2. Pezullimi i vendimit bëhet me propozimin e drejtorisë kërkuese pasi që ka ndryshime në projekt e deri në finalizimin e ndryshimeve në projekt.
3. Pezullimi i vendimit bëhet përkohësisht deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër i cili shfuqizon këtë vendim sipas propozimit të drejtorisë kërkuese.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Drejtoria e Urbanizmit;
- Drejtoria e Kadastrit;
- Zyra e informimit, si dhe;
- Arkivi.



Kryetari,
Zenun Elezaj